

SPOT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 72 Prot
Tiranë, më 18. 02.2022

Nr. 2759 Prot
Shkodër, më 21. 02.2022

KONTRATË DHURIMI ME KUSHT

E lidhur sot më 18/02/2022, midis palëve:

Bashkia Shkodër, me adresë: Rruga 13 Dhjetori, përfaqësuar nga **Znj. Voltana Ademi**, në cilësinë e Kryetares së Bashkisë.

Dhe

Spot Communications, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NIPT K82320007D, me adresë: Rruga "Rezervat e Shtetit", Lundër 1, Njësia Administrative Farkë, Kodi Postar 1045, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Znj. Mirza Alibegaj**.

dhe

Në kuadër të bashkëpunimit publik-privat për mbrojtjen e ambientit, dhe në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve për shfrytëzim të transportit alternativ me biçikleta, si dhe për krijimin e infrastrukturës mbështetëse për këtë transport në të gjithë qytetin e Shkodrës, Spot Communications ka ndërmarrë iniciativën që të dhurojë për përdorim të qytetarëve instalacione për parkimin e biçikletave sipas hartës bashkëngjitur.


Në Bashkinë Shkodër do të instalohen 10 (dhjetë) instalacione për parkimin e biçikletave në vendndodhjet sipas plan-vendndodhjes bashkëngjitur kësaj kontrate dhurimi.

Palët bien dakord për lidhjen e kësaj kontrate si më poshtë vijon:

Neni 1 Baza ligjore

Kjo kontratë dhurimi lidhet në përputhje me:

1. Ligjin Nr 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" të ndryshuar
2. Ligji nr.7850, datë 27.09.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar



Neni 6
Marrja në dorëzim

1. Bashkia Shkodër ngarkohet të marrë në dorëzim 10 (dhjetë) vendparkime për instalimin e instalacioneve për parkim të biçikletave dhuruar nga Spot Communications për Bashkinë Shkodër.
2. Nënshkrimi i Procesverbalit të Dorëzimit nga të dyja palët, vërteton dorëzimin e rregullt të 10 (dhjetë) instalacioneve për parkim të biçikletave dhuruar nga Spot Communications për Bashkinë Shkodër.
3. Palët bien dakort dhe pranojnë që, duke filluar nga çasti i nënshkrimit të Procesverbalit të Dorëzimit nga të dyja palët, Bashkia dhe Spot Communications do të marrin përsipër detyrimet dhe të drejtat sipas përcaktimeve të nenit 4 dhe 5, sipas afatit parashikuar në këtë kontratë.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast mospërbushje të detyrimeve secila nga palët ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë duke njoftuar me shkrim palën tjetër të pakten 30 ditë përpara.
2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt palët i drejtohen për zgjidhjen e tyre Gjykatës kompetente.

Neni 8
Gjuha e kontratës

1. Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

Neni 9
Hyrja në fuqi

1. Kjo kontratë dhurimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 10
Njoftimet

1. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në këtë kontratë bëhen me shkrim, duke iu dorëzuar personalisht personave të kontaktit si më poshtë vijon:

a) Për Spot Communications.

Adresa: Rruga "Rezervat e Shtetit", Lundër 1, Tiranë, Shqipëri
E-mail: jonida.sanco@spot.al; Tel.: 069 40 79 100



Plan vendosje e pikave te parkimit te biçikletave

